



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:139949

Datë: 16.11.2021

Numri i dokumentit: 02403008

**P. nr.329/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit Q. K. nga fsh. . . .Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP/IL. nr.905 /21 të datës 24.06.2021, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **15.11.2021**, në prani të Prokurorit të shtetit Sadri alija Anton Hasanaj si dhe të akuzuarit Q. K., të njëjtën ditë morri dhe publikisht shpalli ndërsa përpiluar me datën 16.11.2021, këtë :

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **Q. K. nga fsh. . . . K Gjakovë**, i biri S. dhe i nënës R. e gjinisë O. Data e lindjes . . . në Gjakovë, ka te kryer shkollën fillore, i pa punë, e gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i pa martuar, ID . . .

**Ë s h t ë f a j t o r**

**Sepse :**

**-me dt.17.05.2021, në fsh. . . K.Gjakovë**, me dashje e përdor forcën ndaj personit tjetër, ashtu që ditën kritike rreth orës 18:00 ne rrugën e fshatit, ishte takuar i pandehuri me të dëmtuarin B. K. në atë mënyrë me të parë, e kap për krahu dhe i thotë, *"ku i kam zogjtë"*!, zogjtë te cilin të njëjtit i ishin vjedhë disa ditë me herët, dhe pasi i dëmtuari i përgjigjet : *unë nuk i kam vjedhur askujt zogjë*, i pandehuri ka vazhduar ta mbaj përsëri për krahu të njëjtin duke e pyetur sërish: *„ ku i kam zogjtë”?*, dhe papritmas e godet me shuplakë në fytyrë për çka i njëjti me veprimin e tij të kundërligjshëm ka shkaktuar me anë të përdorimit të sulmit fizik, forcë në trupin e tij.

**- me çka ka kryer veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 të KPRK-së.**

**Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 69, nenit 184 par. 1 të KPRK dhe nenit 365 te KPPK-së, -së, të akuzuarit i shqipton;**

**DËNIM ME GJOBË**

Dënim me gjobë në shumën prej **200 (dyqind) euro**, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 43 par.3 të KPRK-së ,atëherë i njëjti do t'iu zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10 (dhjet) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)euro**.

I dëmtuara B. K. nga fsh. . . . Komuna Gjakovë ,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30,00 €**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00 €** , në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën , PP/II. nr.905 /21 të datës 24.06.2021, ka akuzuar të akuzuarin Q. K. nga fshati . . .Komuna Gjakovë , për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 15.11.2021, prokurori i shtetit Sadri Alija, lexon aktakuzën PP/II. nr.905 /21 të datës 24.06.2021, me ç 'rast prokurori deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari Q. K. , duke u deklaruar lidhur me fajësinë , lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer të cilën vepër e kam kryer në afekt, kërkoj falje nga i dëmtuari për veprimet e mia , premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem me kujdes të mëtejshëm, i propozojë gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur e gjykatës, premtimin se në të ardhmen do të jem me kujdes të mëtejshëm, gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se është hera re parë që kam ra ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Sadri Alija ,deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Q. K. pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bënte me vullnet të lirë ,pa presion, duke i kuptuar edhe me parë pasojat dhe favorët e pranimi të fajësisë të sqaruara edhe nga ana e gjykatës po ashtu duke marr për bazë se aktakuza ka mbështetje në provat dhe shkruesat që gjenden në lende ku i propozoi gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor ,te dënohet sipas ligjit duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , m oshen e tij te re dhe faktin se i njëjti pranimin e fajësisë e ka bere në të gjitha fazat e procedurës .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike::

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari B. G. : **-me dt.17.05.2021, në fsh. . . . K.Gjakovë**, me dashje e përdor forcën ndaj personit tjetër, ashtu që ditën kritike rreth orës 18:00 në rrugën e fshatit, ishte takuar i pandehuri me të dëmtuarin B. K. në atë mënyrë me të parë, e kap për krahu dhe i thotë, *"ku i kam zogjtë"* !, zogjtë të cilin të njëjtit i ishin vjedhë disa ditë me herët, dhe pasi i dëmtuari i përgjigjet : *unë nuk i kam vjedhur askujt zogjë*, i pandehuri ka vazhduar ta mbaj përsëri për krahu të njëjtin duke e pyetur sërish: *„ ku i kam zogjtë”?*, dhe papritmas e godet me shuplakë në fytyrë për çka i njëjti me veprimin e tij të kundërligjshëm ka shkakuar me anë të përdorimit të sulmit fizik, forcë në trupin e tij, **-me çka ka kryer veprën penale sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së**.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar

provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit . Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarit se i njëjti është i moshës relativisht të re , sjelljen e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekte dhe asnjëherë më parë nuk kanë ra ndesh me ligjin, nuk kanë qenë të dënuar. Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personaliteti i tij që të gjykata janë kuptuar si njeri i sjellshëm, korrekt dhe i vetëdijshëm për pasojat e shkaktuara, është penduar thellë për veprën penale të kryer . Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në çdo fazë të procedurës ,shprehjen e keqardhjes për veprën e kryer , premtimi se në të ardhmen do të jenë më të kujdesshëm dhe nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të ngjashme , kërkim falja publike nga i dëmtuari gjendjen e tij të dobët ekonomike , të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 69 të KPRK-së, Kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me gjobë në shumën prej **200. (dyqind ) euro** , me të cilin dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se ky sanksion do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 € ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së., dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € është marr konform nenit 39 par.3 nën.par.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036. për kompensimin e Viktimave të Krimit .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P.nr.329/21 më datë 15.11.2021.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15ditësh** nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet në Gjykatë.

Numri i lëndës: 2021:139949  
Datë: 16.11.2021  
Numri i dokumentit: 02403008